



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

**KOMUNA E ISTOGUT** në vazhdim "*Njësia e Prokurimit*", të cilën e përfaqëson znj, **Zizë Bujupaj**, menaxhere e Prokurimit, Rruga "*Fadil Ferati*" Nr. 121 në njërën anë; dhe

**SHPK "ADI TE CONSTRUCTION"** nga Cerrolluka, Komuna Istog, të cilën e përfaqëson, z. **Astrit Sylaj**, me Nr. Rexh. Biznesi, 71241939 (në vazhdim "*Kontraktuesit*"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

### TITULLI I KONTRATËS:

#### **RREGULLIMI I BUS STACIONEVE**

|                         |                                |
|-------------------------|--------------------------------|
| <b>Nr. I prokurimit</b> | <b>633-18-4444 / 536/ C108</b> |
| <b>Nr. I brendshëm</b>  | <b>633 / 018 / 036 / 536</b>   |

### **Neni 1 Lënda**

**1.1** Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

#### **RREGULLIMI I BUS STACIONEVE**

### **Neni 2 Çmimi**

**2.1** Çmimi i punëve për punimet "**RREGULLIMI I BUS STACIONEVE**" është: **5.299,00 €** dhe me fjalë: /*Pesë mijë e dy qind e nëntë dhjetë e nëntë euro*/

**2.3.** Oferta financiare e kontraktorit e datës: **09. 07. 2018** është pjesë integrale e kontratës dhe bazë për pagesën e kontratës.

2.4. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.5. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

**Per kontraktorin:**

|                    |                                                                                     |                    |                                                                                       |
|--------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Emri:</b>       | <i>Zize Bujupaj</i>                                                                 | <b>Emri:</b>       | <i>Astrit Sylaj</i>                                                                   |
| <b>Pozita:</b>     | <i>Zyrtar Pergjegjes i Prokurimit</i>                                               | <b>Pozita:</b>     | <i>Me naxher,</i>                                                                     |
| <b>Nënshkrimi:</b> |    | <b>Nënshkrimi:</b> |    |
| <b>Data</b>        | <i>26-07-2018</i>                                                                   | <b>Data</b>        | <i>26.7.2018</i>                                                                      |
| <b>Vula:</b>       |  | <b>Vula</b>        |  |

## **PJESA C: FORMULARI I PARAQITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT**

### **Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT**

Për: **KOMUNA E ISTOGUT** (më tej "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i Kontratës: **"RIPARIMI I BUS STACIONEVE"-ne Komunen e Istogut**

Në përgjigje të letrës suaj të ftesës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr **633-18-4444-5-3-6**. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Çmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

Çmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: **5.299,00.00 euro**

Dhe me shkrim: **PESMI E DYOIND E NENTEDHJETE E NENT euro**

3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej **45 ditë pune** nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

4. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësisht të njohim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të financuara nga BKK.

5. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

### **DORËZUAR NGA:**

| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK |                                |
|------------------------------------|--------------------------------|
| EMRI I KOMPANISË                   | ADI TE CONSTRUCTION.shpk       |
| ADRESA E PLOTË                     | Lidhja e Pejës Corolluke-Istog |
| PERFAQESUAR NGA:                   |                                |
| EMRI                               | Astrit Sylaj                   |
| POZITA                             | Drejtor                        |
| NËNSHKRIMI                         |                                |
| DATA                               | 09/07/2018                     |
| VULA                               |                                |

| KOMUNA E ISTOGUT                                 |                                                                                                                                                                                          |                |       |                 |           |
|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------|-----------------|-----------|
| TITULLI I AKTIVITETIT: RIPARIMI I BUS STACIONEVE |                                                                                                                                                                                          |                |       |                 |           |
| PARAMASA DHE PARALLOGARIA                        |                                                                                                                                                                                          |                |       |                 |           |
| Nr.                                              | Specifikimi i punëve                                                                                                                                                                     | Njësia         | Sasia | Cmimi/<br>Njesi | Gjithsejt |
| 1                                                | Punimi i llamarinës së valëzuar sipas modelit ekzistues për Bus Stacionet e dëmtuara.                                                                                                    | m <sup>2</sup> | 100   | 8               | 800       |
| 2                                                | Ngjyrosja me para ngjyre dhe ngjyre adekuate për metal (llamarinë). Në llogari të futet ngjyrosja e tërë konstruksionit të bus stacionit                                                 | Copë           | 42    | 7               | 294       |
| 3                                                | Përforcimi, sanimi dhe saldimi i shtyllave metalike të dëmtuara të profileve të ndryshme. Llogaria për shtyllat metalike është bërë bazuar në numrin e bus stacioneve të dëmtuara        | copë           | 10    | 10              | 100       |
| 4                                                | Vendosja e një profili me dimensione 3x1mm me gjatësi L=4m, në mesin e konstruksionit të bus stacionit nga pjesa e pasme e tij. Saldimi të bëhet në profilet horizontale ekzistuese.     | Copë           | 4     | 5               | 20        |
| 5                                                | Punimi i konstruksionit komplet të bus stacionit . Modeli si ai ekzistues                                                                                                                | Copë           | 4     | 700             | 2800      |
| 6                                                | Betonimi i bazës së bus stacionit me dimensione 4x1.5m dhe trashësi d=15cm. Betonimi të bëhet me beton të armuar MB 30.                                                                  | Copë           | 4     | 175             | 700       |
| 7                                                | Përforcimi i llamarinës me tipla si dhe konstruksionit metalik me bulona të profileve të ndryshme, për të gjitha bus stacionet                                                           | Copë           | 41    | 5               | 205       |
| 8                                                | Punimi i konstruksionit të ulëseve të dëmtuara sipas atyre ekzistuese,ngjyrosje e tyre me ngjyrë adekuate per metal                                                                      | Copë           | 3     | 50              | 150       |
| 9                                                | Blerja dhe vendosja e dërrasave për ulëse me dimensione 8x5cm dhe gjatësi L=4m dhe ngjyrosja e tyre me ngjyrë adekuate per masen drunore.Llogaria të bëhet për copë të dërrasave.        | Copë           | 9     | 10              | 90        |
| 10                                               | Sanimi dhe perforcimi i bus stacioneve të demtuara. Betonimi bëhet me beton të armuar MB 30, llogaria të bëhet për m3                                                                    | m <sup>3</sup> | 1     | 100             | 100       |
| 11                                               | Zhvendosja e bus stacionit ekzistues në Istog afër marketit "Vatani", transportimi dhe vendosja e tij në fshatin Mojstir. Në llogari të futet edhe ndërtimi i bazës nga betoni i armuar. | copë           | 1     | 40              | 40        |
| TOTALI ME TË GJITHA NGARKESAT                    |                                                                                                                                                                                          |                |       |                 | 5299.00   |

*Ch*

*AP*



*1.3.2023*